



REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primiene Më: 23-12-2016

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broni	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednos
01-013/1710			

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, nenit 2 paragrafi 3, neni 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008, dhe nenit 36 paragrafi 36.2, shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e mbajtur më 21.12.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të nenit 21, nenit 13 pika 13.6 dhe nenit 41 të rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoja

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për pezullimin (lirim) nga pagesa e taksës komunale për të gjithë subjektet afariste të Komunës së Vitisë, të parapara në nenin 21, neni 13 pika 13.6 dhe nenit 41 të rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoja, me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimi e bizneseve në Komunën e Vitisë. Zbatimi i këtij vendimi fillon prej 01.01.2017 deri me datën 31.12.2017.

Neni 2

Obligimet e pa paguara të subjekteve afariste, sipas nenit 21 dhe nenit 13, pika 13.6 dhe nenit 41 të Rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoja, nuk shlyhen, por, pezullohen për pagesa deri me datën 31.12.2017

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi
2. Shërbimit të Kuvendit
3. MAPL
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Naim Pira

